

TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Gazeta TLAS

Botim i Shërbimit Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 2009



**Botimi i këtij materiali është mbështetur
financiarisht nga Vodafone Albania Foundation**



**Vodafone
Albania
Foundation**

TLAS NË NDIHMË TË NJERËZVE NË NEVOJË NËPËRMJET FINAN- CIMIT TË FONDACIONIT “VODAFONE ALBANIA”

Në muajin Shtator 2009 Shërbimi Ligjor Falas Tiranë filloi zbatimin e projektit “Të rrisim aksesin në drejtësi për komunitetet vulnerabël”. Ky projekt financohet nga Fondacioni “Vodafone Albania”.

Fondacioni “Vodafone Albania” nëpërmjet financimeve dhe granteve të tij kërkon të ndikojë në përmirësimin e kushteve të jetesës së njerëzve në nevojë dhe kërkon të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit dhe mbështetjen e komuniteteve në nevojë në shoqërinë shqiptare.

Fondacioni jep grante dhe financime për organizatat me bazë vendore, duke përfshirë organizatat jo-fitimprurëse dhe institucionet e tjera të shoqërisë civile, në mënyrë që t’i përgjigjet nevojave të komunitetit.

Projekti në fjalë synon të rrisë dhe përmirësojë aksesin në drejtësi për të drejtat civile dhe sociale të komuniteteve vulnerabël dhe t’i aftësojë ato të përfitojnë nga te drejtat ligjore në fushën sociale dhe civile me synimin final të zbutjes së nivelit të varfërisë në Shqipëri.

Përveç shërbimeve ligjore falas, të cilat TLAS i ka ofruar gjatë 10 vjeçarit të aktivitetit të tij, një komponent i rëndësishëm i këtij projekti është hartimi i një raporti studimor dhe analize e legjislacionit të ndihmës ekono-



mike dhe përkujdesjes sociale. Nëpërmjet këtij komponenti do të synohet studimi i boshllëqeve dhe mangësive në legjislacionin e ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes sociale dhe do të bëhen rekomandimet përkatëse për ndërhyrjet e mundshme për ndryshimin e këtij legjislacioni ose miratimin e ligjeve ose akteve nënligjore të reja.

Duke qenë se në Programin e saj 2009 – 2013, prioritetet e Qeverisë Shqiptare janë reduktimi i varfërisë nëpërmjet politikave të mbështetjes aktive si dhe përkrahje aktive dhe integruese për individët me aftësi të kufizuar, kjo kërkon një angazhim të

të gjithë faktorëve, qofshin këta shtetërorë ose privatë, në marrjen e masave të drejtpërdrejta dhe efikase për arritjen e qëllimit kryesor të reduktimit të varfërisë. Nëpërmjet vlerësimit të legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe rekomandimeve përkatëse, TLAS kërkon të krijojë një mjedis të përshtatshëm ligjor për të ndihmuar sa më shumë njerëz në nevojë dhe për të zvogëluar numrin e atyre personave që përfitojnë në mënyrë abuzive nga ndihma ekonomike.

Për këtë arsye, TLAS ka lidhur dhe një marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në mënyrë që konkluzionet dhe rekomandimet e rëndësishme për përmirësimin e legjislacionit t'i dërgohen Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për vlerësim të mëtijshëm dhe marrjen e masave për miratimin e tyre nëpërmjet akteve ligjore.

Përfituesit e projektit do të jenë njerëz me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet e një avokati në



mënyrë që të sigurojnë aksesin për të drejtat ligjore dhe sociale. Grupet e targetuara, kryesisht, do të synojnë minoritetin Rom dhe Egjiptian, migrantët, të papunët, të moshuarit, jetimët, nënat kryefamiljare, etj. Më konkretisht:

> Nënat e vetme dhe prindërit që për të regjistruar lindjet e fëmijëve të tyre duhet të kapërcejnë me asistencë ligjore të plotë një sërë procedurash administrative të domoshme dhe të ndërmjetme.

> Individë të veçantë që do të ndërgjegjësohen për përfitimin e shërbimeve ligjore falas gjatë ativiteteve të Street Law dhe publikimeve me gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë, që do të shpërndahen për këtë qëllim. Pritet që më tepër se 1200 individë në nevojë të marrin informacionin e duhur, në 12 aktivitete të tipit Street Law ligjor për të drejtat e tyre ligjore dhe sociale, mënyrën sesi duhet t'i kërkojnë dhe t'i mbrojnë këto të drejta nëpërmjet takimeve në

komunitet, takimeve derë më derë, publikimeve ndërgjegjësuere që do të shpërndahen nga studentët e Programit të Internship-it, etj.

> Punonjësit e strukturave të shtetit që janë në kontakt me individët në nevojë.

Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti TLAS do të ndihmojë njerëzit në nevojë me shërbime ligjore direkte (do të mbështeten dhe përfaqësohen 45 raste përpara organve gjyqësore dhe administrative për regjistrimet civile) si dhe një numër më të madh përfituesish nëpërmjet sugjeri-



meve dhe rekomandimeve për përmirësimin e legjislacionit të ndihmën ekonomike. Përfundimi me sukses i këtij projekti do të krijojë premiset për integrimin në shoqërinë shqiptare të një numri të madh individësh në nevojë dhe përfitimin e të drejtave sociale që atyre iu takojnë.

Raimonda BOZO
Drejtoresh Ekzekutive e TLAS

TLAS në procesin e hartimit të legjislacionit të ndihmës ekonomike

Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore” përcakton sistemin e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore për të dhënë ndihmë ekonomike familjeve të shtetasve shqiptarë, të cilëve ju mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht ose i kanë ato të pamjaftueshme. Në rastet kur është e nevojshme dhe e mundshme, në vend të ndihmës ekonomike ose si shtesë e saj, ofrohen shërbime publike të përkujdesjes shtetërore.

Ndihma ekonomike u jepet familjeve të shtetasve shqiptarë që kanë të ardhura të pamjaftueshme ose që nuk kanë të ardhura materiale jetese nga:

- a. Veprimtaria ekonomike;
- b. Mbrojtja shoqërore ose ndonjë sistem tjetër mbrojtjeje;
- c. Kapital;



d. Anëtarë të familjes jashtë shtetit;

Ndihma ekonomike shpërndahet në formën e “bllok ndihmës” që nënkupton ndihmën, krejtësisht në para, e cila jepet nga shteti për qëllim të caktuar. Masa e ndihmës ekonomike mujore përcaktohet nga Këshilli i Bashkisë i cili merr në konsideratë:

a. Fondin e bllok-ndihmës

b. Vendimin e Këshillit të Ministrave në lidhje me kriteret e familjeve që nuk kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë ekonomike.

Në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Fondacioni “Vodafone Albania”, TLAS ka filluar studimin për identifikimin e boshllëqeve që ekzistojnë në legjislacionin e ndihmës ekonomike dhe kryerjen e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e këtij legjislacioni.

Aktualisht, shumë individë në Shqipëri, me të ardhura të pamjaftueshme, po përbal-

len me faktin se nuk mund të përfitojnë ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore për shkak të mangësive dhe boshllëqeve në legjislacion. Burokracia shtetërore si dhe mosgjethja e zgjidhjeve të duhura nga ana e legjislatorit për një sërë problemesh që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike, bën që shumë individë që nuk kanë të drejtë ta përfitojnë ndihmën ekonomike e përfitojnë atë, ndërsa shumë të tjerë që duhet ta përfitojnë janë lënë jashtë skemave të kësaj ndihme për shkak të boshllëqeve ligjore,





administrative dhe burokratike. Nëpërmjet zbatimit të këtij projekti, TLAS synon të identifikojë mangësitë dhe boshllëqet në legjislacionin e ndihmën ekonomike dhe të propozojë ndryshime të mundshme në këtë legjislacionin ose hartimin e akteve të reja ligjore e nënligjore.

Përmirësimi dhe rinovimi i të gjithë skemës së ndihmës ekonomike është një problem madhor i shtruar për zgjidhje edhe nga Qeveria shqiptare.

Kjo skemë kërkon reformim në mënyrë që të dalë jashtë nga informaliteti dhe të përfitojnë

vetëm ata persona apo ato kategori njerëzish vulnerabël që plotësojnë kriteret që ta përfitojnë atë.

Skema e ndihmës ekonomike që po zbatohet ka mangësi të dukshme që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në buxhetin e shtetit dhe në xhepin e taksapaguesve shqiptarë. Decentralizimi i dhënies së kësaj ndihme ishte një hap i suksesshëm në kuadrin e reformimit të sistemit të ndihmës ekonomike në Shqipëri, por ajo nuk po jep rezultatet e pritshme për shtetasit shqiptarë. Buxheti i shtetit po rëndohet çdo vit nga pagesat e ndihmës ekonomike dhe mundësitë e monitorimit të shpërndarjes së kësaj ndihme janë të paefektshme. Kjo kërkon ndërhyrje ligjore të menjëherëshme, në mënyrë që të përfitojnë individët që i plotësojnë kriteret dhe kushtet për përfitimin e kësaj ndihme si dhe të shmangen nga përfitimi i kësaj ndihme ata individë që nuk i plotësojnë këto kriteret, si dhe të reformohet politika financiare dhe financat publike në përfitim të të gjithë individëve dhe taksapaguesve.

Megjithatë, reformimi i sistemit të ndihmës ekonomike nuk duhet parë si proces i lidhur me pamjaftueshmërinë e fondeve shtetërore për kryerjen e këtyre pagesave, por me përfitimin e kësaj të drejte nga ato kategori që e meritojnë dhe plotësojnë kriteret për këtë ndihmë.

Legjislacioni do të përshatet dhe do të përafrohet me standardet e legjislacionit të ndihmës ekonomike të vendeve europiane. Ky legjislacion duhet parë si komponent që do të forcojë bashkëpunimin social dhe do t'i bëjë organet e pushtetit lokal më të përgjegjshme në zbatimin e detyrave që ato kanë në funksionimin e skemës së ndihmës ekonomike. Madje mund të thuhet që edhe organizatat jofitimprurëse mund të luajnë një rol kyç në mirëfunksionimin e kësaj skeme.

Zbatimi i këtij projekti nga TLAS, duke u ndërthurur edhe me shërbimet e drejtpërdrejta ligjore dhe sociale që do të ofrohen nga TLAS do të ndikojë drejtpër-

drejtë në mirëqënien e kategorive me të ardhura të pakta dhe do të pakësojë abuzimet dhe informalitetin në përfitimin e kësaj ndihme. Në këtë mënyrë do të rritet edhe aksesin në shërbimet sociale për kategoritë vulnerabel që mbrohen dhe përfaqëson TLAS.

Sistemi i ndihmës ekonomike nuk duhet parë vetëm si një sistem që mbrohet të varfërit dhe shtrësat vulnerabel të shoqërisë, por edhe si një sistem që stimulon zhvillimin ekonomik dhe sho-



qëror të të gjithë shoqërisë shqiptare, duke integruar brenda saj edhe këto shtresa vulnerabël dhe jo duke i konsideruar ato si “shtesa anësore” të shoqërisë.

Si, përfundim duhet theksuar se nëpërmjet këtij projekti, TLAS do të ndihmojë grupet vulnerabël të marxhinalizuara në integrimin e tyre në skemën e ndihmës shoqërore.

Elton Lula
Drejtues Projekti i TLAS



Histori e vërtetë

Në fillim të vitit 2003, në Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS) u paraqit një çift nga komuniteti Rom. Nga M. P. Dhe E. P. u prezantua një dukuri, që pothuajse nuk ishte bërë e njohur deri në atë kohë: mosregjistrimi i fëmijëve në afatin e caktuar nga ligji. Dhe konkretisht, vajza e tyre M., pothuajse 3 vjeç dhe djali i tyre S., pothuajse 2 vjeç, nuk ishin të regjistruar në gjendjen civile. Në bazë të ligjit në fuqi, nëse fëmijët nuk ishin regjistruar në gjendjen civile brenda 45 ditëve nga momenti i lindjes, duhej që vërtetimi i lindjes së tyre të bëhej nëpërmjet gjykatës. TLAS mori përsipër të përfaqësonte falas në gjykatë rastin e fëmijëve të M. P.

M. kishte lindur dhe një fëmijë të tretë, A., në fund të vitit 2003, por ajo u ndërgjegjësuara që ta regjistronte këtë fëmijë brenda afatit dhe jo me procedura gjyqësore.

Në Gusht të 2006, M. P., nëna e tre fëmijëve vdiq për shkak të

një sëmundjeje të rëndë, duke lënë tre fëmijë jetimë, vetëm me të shoqin. Babai i fëmijeve nuk ishte në gjendje të rriste tre fëmijët, kështu që TLAS rekomandoi dhe ndërhyri, që për interesin e tyre, do ishte shumë më mirë, që ata të sistemoheshin në Fshatin SOS. Në fakt, babai pranoi që të dërgonte në institucion vetëm dy djemtë e tij, S. A., duke e veçuar M., me arsyetimin që për vajzën do të kujdesej motra e tij.

Në 7 Shtator 2009, grupi i punës i TLAS që organizon takime në komunitet, gjatë një takimi në një nga komunitetet Rome, u takua edhe me M. e vogël. M., që i njeh shumë mirë anëtarët e stafit të TLAS, për arsye se disa herë shoqëronte nënën e saj në zyrë, në takimet me avokatët apo këshilltarët e TLAS, u gëzua pa masë që pa njerëzit me te cilët ishte takuar shumë herë gjatë procesit të regjistrimit të lindjeve, por edhe për transferimin e lejes së banimit të familjes, nga Erseka në Tiranë.

M. ishte rritur tashmë, ishte bërë 9 vjeç dhe po lante një tufë me enë e rroba në oborrin e një barake. Morëm vesh se ajo nuk jetonte me hallën, as me babain, por me një familje fqinjë, e cila e mbante, sepse M. dhe vajza e tyre ishin shoqe. Kuptohet, ky ishte një gjest shumë fisnik i kësaj familjeje me tre fëmijë të vegjël, e cila edhe pse jetonte në kushte ekstreme të varfërisë, nuk refuzonte t'i prishte qejfin M., e cila ishte më e lumtur të jetonte me ta, sesa me të afërmit e babait të saj, që siç dukej, nuk





tregonin kujdesin dhe dashurinë e mjaftueshme për të. Sigurisht, M. ishte e dobishme në familje, sepse ajo angazhohej me punët që i ngarkonin, si p.sh. të kujdesej për bebin, ose të mbushte ujë, ose të lante enë, etj.

M. nuk kishte frekuentuar shkollën asnjëherë edhe pse ishte 9 vjeç, pra nuk dinte shkrim e këndim. Kur e pyetëm a të pëlqen të shkosh në shkollë, asaj i ndritën sytë nga gëzimi. Kur e pyetëm se çfarë dëshiron që të bëhesh kur te rritesh, ajo u përgjigj: “Dua të bëhem mësuese”. Kur e pyetëm

se përse dëshironte të bëhej mësuese, ajo u përgjigj: “Që të mësoj fëmijët romë dhe të mos i rrah, nuk dua që ata të rrihen e të dalin për të lypur”.

Që nga ky takim, mbas bisedës edhe me të atin e M., TLAS filloi të merrej me grumbullimin e dokumenteve dhe ndjekjen e procedurave për të vendosur M. e vogël në Fshatin SOS, për ta bashkuar atë me dy vëllezërit e saj, në mënyrë që ndoshta një ditë, edhe ajo të realizonte ëndrrat e saj. Hapi i parë sigurisht ishte deklarata e miratimit nga ana e babait për ta vendosur vajzën në institucion. Koha kishte treguar se ai nuk ishte në gjendje të kujdesej për të. Më tej, TLAS vazhdoi punën për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, duke i krijuar kështu mundësi M., që të kishte një të ardhme më të mirë.

Histori e vërtetë

B. H. banon familjarisht në Durës, por gjendjen civile e ka në një komunë të një rrethi tjetër. Ai jeton me bashkëshorten dhe dy fëmijët e tij. Fëmija i tij i parë, E. H., ka lindur nga bashkëjetesa me M. K. Për arsye familjare, para 6 vjetësh, nëna e fëmijës ishte larguar nga familja, duke e lënë fëmijën që të rritej në familjen e të atit. Ky fëmijë nuk ishte i regjistruar në gjendjen civile. Ai është, tashmë, 8 vjeç dhe nuk kishte vajtur asnjëherë në shkollë. TLAS filloi menjëherë nga puna për mundësimin e regjistrimit të këtij fëmije në gjendjen civile. Rasti ishte i vështirë dhe kërkohej kohë për këtë regjistrim. Por ndërkohë fëmija duhej regjistruar shpejt në klasën e parë, që të mos humbiste vitin shkollor. Nëpërmjet një rekomandimi me shkrim dhe bisedës telefonike me drejtorin e shkollës, u bë e mundur që E. H. të fillonte shkollën. Më tej TLAS filloi nga puna edhe për regjistrimin e tij në gjendjen civile.

Për vetë faktin që prindërit e fëmijës, B. H. dhe M. K. nuk kishin lidhur martesë, deklarimi i lindjes në gjendjen civile nuk mund të bëhej nga ana e të atit biologjik. Në bazë të ligjit të gjendjes civile, regjistrimi i lindjes së fëmijës në këtë rast, mund të bëhej nga nëna dhe nga çdo pjesëtar tjetër madhor në familjen e nënës. Duke u nisur nga fakti që nënës nuk i dihej adresa e re, TLAS filloi nga përpjekjet për të kontaktuar familjarët madhorë të nënës së fëmijës. Sipas të dhënave të B. H., familja e nënës ishte e regjistruar në një komunë të Beratit. Mbasi kontak-



tuam me punonjësen e zyrës së gjendjes civile të kësaj komune, mësuam që M. K. nuk ishte e regjistruar në fletën familjare të familjes së saj prindërore. Pra kjo familje nuk mund të bënte regjistrimin e fëmijës. E vetmja që mund ta regjistronte fëmijën, ishte nëna e tij. Nëna e kishte regjistrimin në një nga zyrat e gjendjes civile në Tiranë, ku ajo figuronte si beqare.

Mbas shumë përpjekjesh, në bashkëpunim me B. H., mundëm të kontaktojmë me nënën e fëmijës, M. K. Ajo jeton në Tiranë dhe bashkëjeton me një person tjetër. Mbas disa takimeve dhe bisedave me M. K., ajo vendosi që të bëjë regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile të babait të fëmijës, duke njohur atësinë e tij. Ajo u shpreh se është e kënaqur që B.H. është kujdesur gjatë këtyre viteve për fëmijën, por shprehu pakënaqësinë e saj që gruaja e B. H., për shumë vite nuk e ka lënë të takohet me fëmijën e saj.

TLAS organizoi dhe mbështeti financiarisht udhëtimin e dy

prindërve të fëmijës E. H. për në komunën e rrethit Lushnjë, ku është i regjistruar babai i fëmijës dhe aty u bë deklarimi i lindjes dhe njohja e atësisë së fëmijës nga ana e nënës. Kështu fëmija u regjistrua në gjendjen civile dhe mundi të marrë certifikatën e parë të gjendjes civile, si çdo qytetar tjetër. Këtë certifikatë të parë ai do ta çonte në shkollën e tij.

Me ndërmjetësimin e TLAS, babai i fëmijës e solli fëmijën në Ti-



ranë dhe nëna e tij M. K. mundi ta takojë atë pas shumë vitesh, që nuk e kishte parë. Takimi ishte prekës dhe ata i premtuan njëri tjetrit që do takoheshin vazhdimisht.

Histori e vërtetë

Zyra jonë ka ndjekur zgjidhjen e një numri të konsiderueshëm problemesh komplekse, duke ndihmuar në përmirësimin e jetesës, sidomos në komunitetin rom. Më poshtë po përshkruaj një ndër këto raste.

Shtetasi B.I. erdhi në zyrën tonë dhe kërkoi të ndihmohet për të siguruar ndihmë ekonomike nga shteti. Së bashku me familjen e tij prej pesë personash, ai banonte prej disa vitesh në Tiranë, ndërkohë që regjistrimin në gjendjen civile e kishte në Elbasan. B.I. bënte punë të rastit dhe pjesa tjetër e familjes merrej me grumbullimin dhe shitjen e kanoçeve. E sqaruam B.I. që në bazë të legjislacionit në fuqi, familja e tij nuk mund të përfitonte ndihmë ekonomike në Tiranë, edhe sikur të bëhej transferimi i gjendjes civile në Tiranë, sepse asnjë familje e transferuar në Tiranë mbas vitit 1991, nuk gëzon të drejtën e përfitimit të përkrahjes sociale nga shteti, me përjashtim



të rasteve të specifikuar në ligj. Nga biseda që bëmë, morëm vesh, gjithashtu, që ai kishte një fëmijë të moshës 7 vjeç, të paregjistruar në gjendjen civile, për shkak se fëmija kishte lindur në kushte shtëpie dhe në bazë të ligjit, regjistrimi i fëmijës në gjendjen civile mund të bëhej vetëm mbas vërtetimit të faktit të lindjes nga ana e gjykatës.

Duke parë që kjo familje kishte shumë probleme për të zgjidhur, sipas një plani të përcaktuar, filluam ta ndihmonim që të zgjidhte hap pas hapi problemet e saj.

Së pari, filluam përgatitjen e dokumentave për procedurat e transferimit të gjendjes civile, nga vendbanimi i mëparshëm, në vendbanimin e ri, në Tiranë. Mbas realizimit të procedurave të nevojshme administrative nga zyrat përkatëse të gjendjes civile, familja e B.I. u bë zyrtarisht banore e Tiranës. Duke qenë banore e Tiranës, kjo familje mund të mernte më lehtësisht ndihmë të mëtejshme ligjore nga ana e zyrës sonë.

Së dyti, grumbulluam dokumentat e nevojshme për fillimin e procedurave gjyqësore për konfirmimin e lindjes së fëmijës dhe dorëzuam kërkesën në Gjykatën e Rrethit të Tiranës. Mbas përfundimit të procedurave gjyqësore nga ana e avokatëve të TLAS, u bë i mundur regjistrimi i fëmijës në zyrën e gjendjes civile. Tashmë ky fëmijë nuk ishte pa identitet dhe si i tillë, mund të gëzonte të gjitha të drejtat që i takonin.

Së treti, në bashkëpunim me familjen, e regjistruam fëmijën



në klasën e parë, duke bërë të mundur largimin e tij nga rruga dhe fillimin e një jete të re, më të mirë.

Mendojmë se me punën tonë arritëm që të sjellim në normalitet jetën e një familjeje, që për shkak të varfërisë dhe nivelit të ulët arsimor, nuk ishte në gjendje të kërkonte të drejtat e saj.

Elvira Dervishi
Këshilltare e TLAS
TLAS



Të drejtat e të paraburgosurve dhe eksperiencia e TLAS në mbrojtjen e tyre në rrugë gjyqësore

Këto të drejta janë sitë përgjithshme si, trajtim human, i barabartë dhe pa asnjë diskriminim të hapur ose të fshehtë mbi baza besimi, përkatësie fetare, etnike, politike, pozite sociale etj., ashtu edhe specifike, pra të lidhura më gjendjen e tyre të veçantë, “kufizim i lirisë për shkak të statusit “i paraburgosur”. Të drejta të tilla janë , takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët duke pasur kohë të mjaftueshme në konfidencë të plotë; fjetje në krevat të veçantë me rroba fjetjeje sipas kushteve klimaterike; ushqim tre herë në ditë sipas normave të përcaktuara; të kenë llogarinë personale, të cilën mund ta përdorin për nevojat e tyre; të takohen me familjarët e të afërmit e tyre dhe të marrin ushqim e rroba prej

tyre, shërbimi mjekësor 24 orësh, nën kujdesin e personelit mjekësor në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë, si dhe të bëjnë vizita privatisht me shpenzimet e tyre; të paraqesin kërkesa dhe ankesa te personeli i Institucionit, si dhe çdo institucioni tjetër dhe të marrin përgjigje brenda afateve ligjore; t'u sigurohet e drejta dhe fshehtësia e korrespondencës; kanë të drejtën e bisedave, telefonatave; kanë të drejtën e ajrimit; të marrin pjesë në aktivitete argëtuese, edukative dhe pune, të ushtrojnë besimin dhe

ritet fetare; t'u sigurohet asistencë social psikologjike dhe konsulencë juridike; të përdorin sendet personale të lejuara në rregullore.

Në të gjitha takimet e personelit të TLAS-it me personat e paraburgosur i është kushtuar vëmendje e veçantë sqarimit të tyre lidhur me faktin se ata duhej të vlerësonin veten e tyre si shtetas të një shoqërie të organizuar mbi parimin e "shtetit të së drejtës" të cilët gëzonin të gjitha të drejtat e shtetasve të tjerë me përjashtim të kufizimit të lirisë së rrjedhur nga statusi i tyre "i paraburgosur" dhe rrethanave që lidhen domosdoshmërisht me këtë status. Ky ndërgjegjësim është i domosdoshëm për këtë kategori personash pasi, në mënyrë të veçantë grupi i personave në gjëndje të vështirë ekonomike, pra për pasojë edhe me nivel më të ulët arsimor e kulturor "pajtohen" me kushtet jo të mira të banimit duke e konsideruar këtë si "normalitet" për shkak të një opinion mbizotërues sipas të cilit "kushtet e burgimit janë të rënda".



Duke i sqaruar këta shtetas për të drejtat e tyre, është punuar shumë edhe për sqarimin e rrugëve të realizimit dhe mbrojtjes së këtyre të drejtave. Këto të drejta, duke qenë të tilla pasi janë parashikuar nga ligji, përbëjnë njëkohësisht detyrime për administratën e Institucioneve të Paraburgimit pranë të cilave qëndrojnë ata. Në këtë këndvështrim kërkimi i realizimit të tyre nuk duhet vlerësuar si “privilegj” por si respektim i detyrimeve të rrjedhura nga ligji.



Rrugët nëpërmjet të cilat mbrohen ato janë të shumta, duke filluar me ankimin administrative tek organet më të larta administrative (në rrugë hierarkike), nëpërmjet Avokatit të Popullit, si një organ shtetëror me shumë reputacion para administratës së Institucioneve të Paraburgimit, ankimeve pranë Organizatave Jofitimprurëse, misioni i të cilave ka në fokus të drejtat e të paraburgosurve si dhe nëpërmjet gjykatës si rruga më efektive dhe përfundimtare për realizimin e të drejtave të refuzuara nga administrata e Paraburgimit.

Në intervistat e zhvilluara, të cilat synonin që të nxisnin të paraburgosurit të realizonin të drejtat e tyre nëpërmjet ankimeve në rrugët e mësipërme kemi ndjerë vështirësinë e bashkëpunimit të tyre. Kjo është shprehje qoftë e faktit që paraburgimi shihet prej tyre si një periudhë kalimtare dhe shpesh e shpejtë për të cilën nuk shohin ndonjë interes të drejtëpërdrejtë për të ankimuar (sidomos në rrugë gjyqësore për shkak të kohës relativisht të zgjatur që kërkon ky mjet



ankimi) ashtu edhe mosbesim i të paraburgosurve për efektivitetin e ankimit të tyre.

Në strategjinë e “gjetjes” së rasteve, pra të personave të paraburgosur të cilëve u ishte refuzuar një e drejtë dhe që të ishin të gatshëm të bashkëpunonin me avokatët e TLAS-it për të realizuar një ankim gjyqësor u punua në evidentimin e rasteve për të verifikuar respektimin e të drejtave që lidheshin me të drejta themelore si, jeta, shëndeti, liria.

Në mbrojtje të shëndetit vështirësia më e madhe rezultoi në evidentimin e faktit të paligjshëm, pra mungesën e kujdesit shëndetësor të shpejtë dhe cilësor dhe një pasojë të drejtëpërdrejtë në dëmtimin e shëndetit. Ndonëse u paraqitën disa persona të cilët kishin pretendime të kësaj natyre dhe u treguan të gatshëm të bashkëpunonin me avokatët e TLAS-it, vlerësimi i fakteve të pretenduara prej tyre paraqiste vështirësi për shkak të nevojës së njohurive të posaçme në fushën e shëndetit (mjekësore). Me bashkëpunimin e Institutit European të Tiranës kjo vështirësi është kapërcyer dhe tanimë janë krijuar të gjitha kushtet e përshtatshme që të verifikohen në mënyrë të plotë këto raste dhe të vlerësohen situatat e përshtatshme për të përdorur rrugën gjyqësore në mënyrë të suksesshme në mbrojtje të të drejtave të paraburgosurve.

Një grup tjetër i rëndësishëm i rasteve të paraqitura është ai që lidhet me “zgjatjen e kohës së paraburgimit”.

Nga vizitat në Institucionet e Paraburgimit janë evidentuar shumë raste në të cilat personat e paraburgosur qëndrojnë në këto Institucione edhe tej kohës së caktuar në aktin përkatës (vendimin e gjykatës). Nga vlerësimi i rasteve të evidentuara është konstatuar se kjo gjë ndodh për shkak të vonesës së lëshimit të urdhërit të ekzekutimit nga ana e organit të prokurorisë e cila nga ana e saj tregon si shkak vonesën e organeve gjyqësore (gjykatat e apelit) për të dorëzuar në kohë vendimet gjyqësore për ekzekutim.

Pavarësisht nga shkakut është evident fakti se shumë shtetas qëndrojnë për kohë shumë të gjatë në Institucionet e Paraburgimit ndërsa, sipas ligjit duhet të transferohen në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve me Burgim sapo vendimi penal të marrë formë të prerë.

Sipas ligjit penal (Kodit Penal, neni 57) koha e kaluar në “paraburgim” nuk është e njëlojtë me kohën e kaluar në sta-

tus “burgimi” duke u parashikuar edhe raporti i konvertimit, 1:1.5. Ky rregullim ligjor buron nga fakti që ligjvënësi ka mbajtur parasysh kushtet e ndryshme që kalon një shtetas në këto dy statuse, “i paraburgosur” dhe “në vuajtjen e dënimit me burgim”.

Në rastin konkret, organet përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale (organi i Prokurorisë) zbaton në mënyrë të kufizuar këtë rregull. Ky organ llogarit konvertimin e “paraburgimit” me “burgim” duke mbajtur parasysh vetëm



statusin ligjor dhe jo faktik të kësaj gjendjeje. Pra, ndonëse një shtetas qëndron në paraburgim edhe pasi vendimi ka marrë formë të prerë, dhe për rrjedhojë ai duhet të transferohet në një Institucion të Ekzekutimit të vendimit me Burgim, periudha e qëndrimit “de facto” në këtë Institucion (pasi vendimi ka marrë formë të prerë) nuk i nënshtrohet rregullit të konvertimit.

Në kushtet që ky qëndrim tej kohës së parashikuar nga ligji (deri sa vendimi të marrë formë të prerë) shpesh është shumë i zgjatur (kemi evidentuar edhe

raste mbi 6 muaj), avokatët e TLAS-it e kanë konsideruar si cënim të të drejtës së paraburgosurit për kufizimin e lirisë. Si pas vlerësimit tonë ligji penal ka parashikuar konvertimin duke u nisur nga diferencat e kufizimeve që kanë shtetasit në këto dy Institucione (Paraburgim dhe Burg). Për rrjedhojë rregulli ligjor i konvertimit duhet të shtrihet mbi të gjithë periudhën e qëndrimit “de facto” në Institucionin e Paraburgimit dhe jo vetëm mbi statusin “ligjor” se në cilin rast personi konsiderohet “de jure” “i paraburgosur”.

Duke e konsideruar këtë qëndrim të organit të Prokurorisë si një veprim që cënon të drejtat themelore të këtyre shtetasve janë hapur disa procese gjyqësore në mbrojtje të të drejtave të shtetasve të paraburgosur.

Vangjel KOSTA
Avokat i TLAS



Histori e vërtetë

Klientia Q.SH është pjesëtare e komunitetit Rom. Ajo është paraqitur përpara TLAS pasi kërkon ndihmë ligjore për të fituar kujdestarinë për mbesën e saj të mitur.

Q.SH ka mëse 7 vjet që kujdeset për të miturën, të cilën vajza e saj e ka braktisur pas divorcit me të atin e saj, duke u larguar në drejtim të paditur, për të kërkuar punë. Që nga ai moment ajo nuk është kthyer më në Shqipëri. Që nga ajo ditë kanë kaluar një kohë e gjatë më shumë se 7 vjet, gjatë së cilës për shkak të lidhjes familjare me të miturën (mbesa) klientia Q.SH është perkujdesur për të, për nevojat bazë, por mungesa e një statusi ligjor për situatën e krijuar e pengon atë që t'i realizojë në mënyrë të plotë të drejtat e të miturës në raport me institucionet shtetërore, apo me të tretët. Ndërkohë që i ati që nga momenti i zgjidhjes së martesës nuk ka treguar interes për të miturën.

Prindërit e të miturës në rrethanat që ndodhen janë në pamundësi të ushtrimit të përgjgjësisë prindërore, për shkak të mungesës (neni 224 i K.Familjes) duke qënë se janë larguar përkohësisht jashtë shtetit duke e lënë fëmijën pranë gjyshes nga ana e nënës së saj, në shtëpinë ku nëna e të miturës bashke me të miturën jetonte pas zgjidhjes së martesës ligjore me babain e të miturës.

Neni 263 i Kodit të Familjes parashikon rastet e vendosjes në kujdestari të të miturit dhe



shprehet se: “Fëmijët e mitur vendosen në kujdestari dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti kur prindërit e tyre janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore, si dhe për çdo shkak tjetër të pranuar nga gjykata”.

Në këtë rast mungesa e prindërve të cilët ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijës të tyre të mitur mund të përbëjë shkak për t’u vlerësuar nga gjykata për vendosjen e të miturës në kujdestari nga një anëtar i familjes duke mbajtur në konsideratë

interesin më të lartë të fëmijës (neni 2 i K.Familjes).

Duke pasur parasysh sa më sipër si dhe faktin se me kujdestari do të kuptojmë atë institut ligjor i cili garanton marrjen në mbrojtje, në kujdes dhe në përgjegjësi nga kujdestari të të miturit të cilët për shkaqe të ndryshme ka mbetur pa kujdesin prindëror, avokati i TLAS-it filloi procedurat gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që Q.SH të fitojë kujdestarinë për mbesën e saj.



Histori e vërtetë

Pranë zyrës së TLAS u paraqit klientia M.K e cila kërkoi ndihmë ligjore për largimin e padrejtë nga puna.

M.K kishte punuar për më shumë se 6 vjet pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare në pozicionin “specialiste”.

Përmes një shkrese nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, M.K i është komunikuar “lirimi nga detyra” me motivacionin “shkurtimi i pozicionit nga organika e re”.

Klientia ishte shumë e dëshpëruar, pasi komunikimi për largimin nga puna kishte qënë i papritur, pa respektuar asnjë procedurë që kërkon ligji, duke e lenë në mes të katër rrugëve, pa asnjë të ardhur, dhe mbi të gjitha me një familje për të ushqyer.

Avokati i TLAS pasi e mori dosjen nga keshilltarja filloi punën për ndjekjen gjyqësisht të çështjes.

Marrëdhëniet e punës midis M.K dhe Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, rregullohen

nga Kodi i Punës dhe në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës për shkak “të shkurtimit të vendit të punës”, punëdhënësi ka këto detyrime ligjore ndaj punëmarrësit:

1. Respektimin e afatit të njoftimit

Sipas nenit 143 të Kodit të Punës, “Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periodhe të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet punë, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet punë.”





rime për ndryshimin e marrëdhënies së punës, përfshirë edhe “largimin nga detyra”, si vepërimi me pasojat më të rëndësishme në marrëdhëniet e punës, të dëgjojë punëmarrësin të shprehë opinionin e tij për veprimet që do të kryhen me kontratën e tij të punës. Ky parim i rëndësishëm kushtetues (proces i rregullt ligjor- neni 42/1 i Kushtetutës së R. së Shqipërisë”) gjen zbatimin e vet në nenin 144 të Kodit të Punës.

Ky afat nuk është respektuar nga punëdhënësi.

2. Moszbatimin e procedurave të rregullta të largimit

Shkresa e “lirimit nga detyra”, duke i dhënë fund një marrëdhënie juridike të punës duhej të respektonte parimet themelore që garantojnë të drejtat e punëmarrësve sipas legjislacionit të marrëdhënie të punës.

Në thelb të këtij parimi qëndron “e drejta e mbrojtjes nga veprimet e padrejta të punëdhënësit”. Për të garantuar këtë të drejtë, punëdhënësi ka detyrim që, para se të ndërmarë vep-

Duke qenë se asnjë nga detyrimet e mësipërme nuk ishin respektuar nga punëdhënësi i klientes M.K, çështja në gjykatë u zgjidh me sukses për klienten M.K e cila me ndihmën e TLAS arriti të përfitojë një shpërblim prej 10 pagash mujore.

Histori e vërtetë

Pranë zyrës së TLAS-it u paraqit klientja Q.B së bashku me vajzën e saj L.H.

Të dyja ishin pjesëtare të komunitetit Rom. Ato u paraqitën pranë TLAS pasi kishin një problem ligjor, dhe duke qënë se nuk kishin mundësi ekonomike për të patur një avokat, pasi ishin të papuna dhe nuk kishin asnjë të ardhur financiare, kishin marrë informacion se TLAS ofronte ndihmë ligjore falas.

Q.B përpara 20 vjetëve kishte lindur një fëmijë të seksit femër të cilën më vonë e kishte qujtur L.H. Kushtet në të cilat e kishte lindur fëmijën, ishin jashtë institucionit shëndetësor, pasi së bashku me bashkëshortin në atë kohë (babin e vajzës) kishin qenë duke u zhvendosur nga vendbanimi tyre.

Nisur nga mungesa e edukimit dhe gjendja ekonomike, klientja Q.B nuk kishte bërë regjistrimin në gjendjen civile të lindjes së



vajzës, pasi kishte qenë në pamundësi të pajisjes me një dokument që vërtetonte lindjen e vajzës, duke qenë se e kishte lindur në kushte jo normale (në barraka).

Në këto kushte përgjithë këto vite vajza e saj ka mbetur e paregjistruar në regjistrat themeltar të gjendjes civile, duke e penguar të shkonte në shkollë.

Tashmë vajza e L.H është rritur dhe bashkëjeton me një burrë me të cilin ka bërë tre fëmije që

kanë mbetur të paregjistruar si pasojë e mosregjistrimit të nënës së tyre.

Në këto kushte avokati i TLAS filloi menjëherë procedurat gjyqësore për regjistrimin e vajzës L.H përmes gjykatës, që më pas të regjistrohen edhe tre fëmijët e saj.

Naureda LLAGAMI
Avokate e TLAS



Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit një kliente e komunitetit Rom e cila jetonte në qytetin e Tiranës me iniciale E.P. Pasi kishte marrë dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të afërm, ajo u paraqit duke kërkuar konsulencë ligjore në lidhje me problemin për braktisjen e femijes së saj të mitur .

Pasi u krye një intervistë me të u identifikuan problemet e saj. Nga intervista u konstatua se klientja E.P nga martesja me shtetasin A.P kishte lindur një fëmijë, të quajtur A.P.

Më pas për shkak të grindjeve të shumta me bashkëshortin, klientja E.P është larguar nga banesa dhe ka shkuar të jetojë në shtëpinë e prindërve të saj.

Pasi ka lindur djali, A.P., rreth dy muaj e gjysëm pas lindjes kërkuesja është kujdesur për të vazhdimisht dhe ai ka jetuar me të duke u kujdesur ajo e vetme për të.

Pas ketij momenti bashkëshorti i ka kërkuar që të bashkohet përsëri dhe i ka kërkuar djalin që të çojë në shtëpi.

Më pas të afërmit e fëmijës nga babai janë paraqitur pranë organeve të policisë duke denoncuar dhe akuzuar prindërit e djalit për braktisje të fëmijës.

Më pas ka marrë dijeni që femija ishte vendosur pranë maternitetit nr. 1 Tiranë. Kërkuesja është interesuar menjëherë pranë institucionit duke u paraqitur për të marrë sërish fëmijën duke marrë parasysh edhe moshën e tij të mitur dhe nevojën e madhe që ka për praninë e nënës. Pasi është interesuar pranë këtij institucioni për të marrë fëmijën nga ana e institucionit i është refuzuar kthimi i fëmijës.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë duke marrë përsipër përgatitjen e të gjithë dokumentave nevojshëm dhe ndjekjen e procesit hetimor deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një kërkesë drejtuar prokurorisë për zhvillimin e hetimeve.

U paraqitëm bashkë me klienten E.P pranë institucionit të prokurorisë dhe dhamë të gjithë shpjegimet e nevojshme në lidhje me çështjen duke paraqitur edhe pretendimet tona.

Vetë ligji dhe Kodi i Familjes e njeh nënën e fëmijës si kujdestare të vetme të këtij fëmije dhe nuk duhet të pengohet nga asnjë organ ose individ për të qëndruar bashkë me fëmijën e saj, pasi edhe për vete



çështjen që po hetohet duket qartë fakti që nëna nuk e ka braktisur asnjëherë fëmijën e saj por përkundrazi ajo ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të jetuar përsëri me fëmijën e saj.

Me pas u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa letërkëmbime me maternitetin dhe organin e prokurorisë, gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen dhe duke dhënë konsulencë të vazhdueshme. Arritëm në përfundimin se klientja E.P kishte të drejtë në pretendimet e saj duke i dhënë në këtë mënyrë të drejtë dhe realizuam bashkimin me fëmijën e saj të mitur.

Histori e vërtetë

Pranë Zyrës tonë u paraqit klientja A.A. e cila jetonte në qytetin e Tiranës. Pasi kishte marrë dijeni për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet publikimeve të afishuara pranë gjykatës, ajo u paraqit duke kërkuar konsulencë ligjore për problemin e saj për gabimet që ishin kryer në lidhje me identitetin e saj në dokumenta zyrtarë të lëshuara nga institucionet shtetërore.



Pasi u krye një intervistë me të, u identifikuan problemet e saj. Nga intervista u konstatua se klientja A.A kishte mbaruar fakultetin në Tiranë dhe në diplomën e saj mbiemri ishte shënuar gabimisht dhe jo mbiemri i vertete i saj, gabim i cili e bënte të papërdorshëm këtë dokument pasi dyshohej për identitetin e personit që paraqiste dokumentin.

Me gjithë interesimin e madh të klientes A.A për ta zgjidhur këtë çështje në rrugë administrative pasi edhe nga vetë fakulteti pra-



nohej fakti që ajo kishte qenë studente dhe kishte mbaruar studimet, përsëri nuk pranonin të bënin korigjimin e mbiemrit të saj.

U paraqit çështja në mbledhjen e radhës së Zyrës dhe nga diskutimet u arrit në përfundimin se kjo çështje mund të ndiqej nga avokatet e zyrës tonë duke marrë përsipër përgatitjen e të gjithë dokumentave nevojshëm dhe ndjekjen e procesit gjyqësor deri në zgjidhjen përfundimtare të tij.

U shqyrtua rasti dhe u mendua që të përpilohej një padi me objekt “njohjen e vërtetësisë së dokumentit të shkollës së lartë të klientes A.A ”.

Sipas nenit 32 pika “c” të Kodit të Procedurës Civile padia mund të ngrihet:

“për njohjen e vërtetësisë ose të pavërtetësisë së një dokumenti me pasoja juridike për paditësin”

Ky gabim material kishte ardhur si pasojë e gabimeve materiale

ose të pakujdesive të kryera nga ana e punonjësve të fakultetit që kanë qenë përgjegjës për hedhjen e të dhënave në regjistër. Ky fakt, kishte krijuar mjaft probleme, pasi klientja A.A nuk mund ta përdorte diplomën në specializime të tjera pasuniversitare brenda ose jashtë vendit.

Këtë fakt ajo nuk mund ta provonte në asnjë rrugë tjetër veç asaj gjyqësore, dhe nga vërtetimi i këtij fakti rrjedhin pasoja juridike që lidhen me efektet e

realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të shtetasve

U depozitua kërkesë-padia në gjykatë dhe u procedua me hapat e mëtejshëm, ku u zhvilluan disa seanca gjyqësore. Gjatë kësaj kohe vazhdimisht çështja u ndoq nga avokati i caktuar duke përgatitur dokumentacionin ligjor në lidhje me çështjen dhe duke dhënë konsulencë të vazhdueshme. Gjykata arriti në përfundimin se klientja A.A kishte të drejtë në kërkimin e saj duke i dhënë në këtë mënyrë të drejtë për kërkimin e saj dhe njohjen e vërtetësisë së diplomës së shkollës.



Zgjidhja e Martesës për Shkak të Ndërprerjes së Jetesës së Përbashkët

Pranë Zyrës tone, rreth dy vjet, më parë u paraqit një klient rom me iniciale F.K, pasi kishte marrë vesh për shërbimet që kryente zyra jonë nëpërmjet personave të tjerë. Ai u paraqit duke kërkuar zgjidhjen e martesës nga bashkëshortja e tij e cila jetonte prej kohësh në shtetin Grek.

Zgjidhjet e martesave këto vitet e fundit përveçse janë shtuar shumë, në komunitetin rom vihet re një numër shumë i madh divorcesh. Gjithashtu, në të njëjtën kohë duke qenë të martuar vihet re një fenomen tjetër i cili është ai i bashkëjetesës gjatë kësaj kohe me persona të tjerë dhe lindja e fëmijëve me bashkëjetuesit respektivë.

Sipasnenit 129 të Kodit të Familjes “Secili nga bashkëshortët mund te kërkojë zgjidhjen e martesës për shkak te ndërprerjes se jetesës së përbashkët kur bashkëshortët jetojnë të ndarë fak-

tikisht që prej 3 vjetësh.

Nëse është rasti, bashkëshorti që kërkon zgjidhjen e martesës, sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të përcaktojë në kërkesë-padinë e tij dhe mënyrën e zbatimit të detyrimeve të mundshme kundrejt fëmijëve të tij dhe bashkëshortit tjetër”.

Në kushtet e përshkruara më lart klienti F.K kërkonte divorcin për disa nga shkaqet e përmendura më sipër.



U procedua me marrjen e dokumentave të nevojshme për fillimin e gjyqit gjë e cila mori pak kohë pasi duke marrë parasysh se klientja ishte rom dhe duke qenë së romët lëvizin shpesh gjatë vitit nga banesat e tyre e vështirësoi edhe më shumë gjetjen dhe plotësimin e të gjithë dosjes për në gjykatë.

Në kërkesën e paraqitur në Gjykatë u kërkuu edhe që këtyre fëmijëve t'i lidhej një pension ushqimor deri sa të mbushnin moshën madhore gjithashtu duke marrë parasysh edhe fak-

tin që ishin 5 (pesë) fëmijë.

Neni 138/1 i Kodit të Familjes shprehet: "Në kërkesë-padinë për zgjidhjen e martesës mund të kërkohet edhe detyrimi i bashkëshortit tjetër për të përballuar shpenzimet për detyrimin për ushqim, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve, shpenzimet për jetesë të bashkëshortit nevojtar, në rastet e parashikuara në këtë Kod".

Gjykata pas një shqyrtimi gjyqësor të hollësishëm arriti në përfundimin se kjo martesë nuk mund të vazhdonte dhe vendosi zgjidhjen e saj. Përsa i përket fëmijëve gjykata vendosi që ata të jetojnë me babain e tyre për faktin e moshës së disa prej tyre por edhe për përkujdesje më të madhe nga ana e saj. U vendos edhe një pension ushqimor për secilin nga fëmijët të cilin do e paguante babai i tyre sipas rregullave të vendosura nga gjykata.

Adrian Shega
Avokat i TLAS



Aktivitetet e Street Law të TLAS, për ndërgjegjësimin e komunitetit

Një nga mënyrat e rëndësishme të ofrimit të shërbimeve ligjore nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë janë aktivitetet e formës “Street Law” (ndërgjegjësimit ligjor të publikut). Këto aktivitete organizohen për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit publik për të drejtat e njeriut, problemet dhe çështjet ligjore dhe sociale. “Street Law” është një aktivitet që udhëhiqet nga studentët e Programit Internship të TLAS, që kryejnë praktikën mësimore pranë kësaj zyre, kështu studentët udhëtojnë çdo javë nëpër zonat urbane dhe rurale të ndryshme.

Studentët transmetojnë informacionin e nevojshëm për shërbimet në zyrë, shpërndajnë publikimet e përgatitura nga stafi i zyrës, si postera, broshura, etj. Është e rëndësishme njohja

e këtyre komuniteteve apo lokaliteteve për qëllimin e zyrës së TLAS, duke qenë se ka një mungesë të theksuar informacioni për aksesin e komunitetit në drejtësi.

Puna e studentëve konsiston në kontaktin, takimin me çdo banor, personalisht dhe në grup, të komunitetit të vizituar dhe informimi se si mund të përfitojnë shërbime ligjore falas nga zyra e TLAS për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Gjatë këtyre takimeve shpërndahen publikime të zyrës, si dhe merren shënime rastet kur





këta persona mund të behen klientë që ndihmohen nga zyra e TLAS. Përveç publikimeve, personave u jepen dhe numrat e kontaktit të zyrës, të cilat janë të vendosura dhe në broshurat e shpërndara.

Përtë qenë më afër problemeve të tyre dhe për t'i prekur realisht ato, me synim që shërbimi që ofrojmë të jetë sa më cilësor dhe i dobishëm, ne shkojmë në çdo ambient ku komuniteti vulnerabel jeton, banon dhe punon. Komuniteti ku kemi qenë më shumë të pranishëm, ka qenë ai

rom, duke patur parasysh faktin se ky komunitet ka me të vërtetë nevojë për shërbimet ligjore të ofruara nga zyra e TLAS.

Gjate muajit shtator 2009 janë zhvilluar dy aktivitete të tipit “Street Law” në dy zona të qytetit të Tiranës, konkretisht në zonën e “Bregun e Lumit” dhe në atë të “Selitës”. Në këto zona është e përqëndruar më shumë komuniteti Rom. Gjëja e parë që bie në sy, është varfëria me të cilën jeton ky komunitet. Strehimet e tyre, nuk janë shtëpi, por barake të ndertuara të cilat nuk ofrojnë as kushtet më minimale të jetesës. Dhe infrastruktura e këtyre zonave, lë shumë për të dëshiruar, duke qenë se nuk është vënë dorë në sistemin e kanalizimeve, energjisë apo të ujit të pijshëm. Gjithashtu, në këto zona vihet re mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe institucioneve të paraedukimit duke vështirësuar integrimin e tyre me pjesën tjetër të shoqërisë. Pavarësisht këtyre problemeve ekzistuese dhe ankimave të vazhdueshme nga ana

e tyre, ka munguar gjithmona dora e shtetit.

Në datën 6 shtator 2009, u bë përgatitja e planit të punës për “Street Law” të datës 7 shtator. Përgatitja konsistoi në përcaktimin e planit të punës, llojin e aktivitetit, përcaktimin e komunitetit, materialet përkatëse që do të përdoren dhe sigurimin e transportit.

Realizimi praktik i aktivitetit “Street Law” u bë me 7 shtator 2009. Puna jonë u realizua në zonën e “Bregut të Lumit” Tiranë. Në këtë aktivitet, puna e studentëve u asistua dhe nga stafi i zyrës si: Drejtorja Ekzekutive e TLAS-it, Znj. Rajmonda Bozo, Këshilltarja paraligjore Znj. Elvira Dervishi, Avokat Vangjel Kosta dhe Migen Elmazi. Ndërsa studentët pjesëmarrës ishin: Rina Pero, Elson Metalla, Brisilda Taço dhe Lurand Llagami.

Banorët e zonës së “Bregut të Lumit” na informuan rreth problemeve të shumta ligjore si mosregjistrimi i fëmijëve pavarësisht

se ata ishin në moshë të madhe, bashkejtesa e personave jashtë lidhjes martesore, probleme në lidhje me transferimin e dokumenteve dhe kalimin e tyre në zyrat e gjendjes civile që kanë juridiksion në këtë zonë, raste për zgjidhje martese, kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, probleme rreth përfitimit të pensioneve dhe largimin pa të drejtë nga puna. Të gjitha këto raste u mbajtën shënim nga stafi i TLAS.

Materialet e shpërndara ishin: rreth 35 revista nr. 1 dhe 2 të vi-



tit 2008 mbi regjistrimin e fëmijëve, dhe rreth 20 revista nr. 1 dhe 2 të vitit 2009. Gjithashtu, u ngjitën dhe 5 postera mbi strukturën dhe shërbimet e ofruara nga TLAS. Numri i përgjithshëm i përfituesve ishte 75 persona. Aktiviteti i datës 7 shtator 2009, zgjati rreth 4 orë dhe u mbyll me realizimin e programit të parashikuar.

Në datën 27 shtator 2009, u bë përgatitja e planit të punës për “Street Law” të datës 28 shtator. U ndoq e njëjta procedurë e datës 6 shtator. Realizimi praktik i aktivitetit u realizua me 28 shta-

tor 2009, në zonën e “Selitës”. Në këtë aktivitet asistuan: Keshilltarja paraligjore Znj. Elvira Dervishi, si dhe studentët Elson Metalla, Rina Pero, Blisilda Taço. Në këtë aktivitet u shpërnda i njëjti material i publikuar nga zyra, dhe u informua komuniteti rolin dhe veprimtarinë e TLAS, çështje të ndryshme ligjore dhe sociale që ata i shqetësojnë, si përshembull regjistrimi i lindjeve, i vdekjeve, transferimi i dokumenteve të gjendjes civile, zgjidhjet e martesës, përfitimi nga skema e ndihmës sociale, etj. Kjo punë u realizua me atë pjesë të komunitetit që i intervistonim për herë të parë dhe nuk ishin në dijeni për zyrën tonë. Gjithashtu, rikontaktuam disa nga banoret, që përfitonin nga zyra jone, por që kishin sërish nevojë për asistencë ligjore.

Materialet që u shpërndanë ishin revista rreth ndihmes juridike që ofron TLAS (rreth 40 kopje), broshura për hapat që duhen ndërmarre për regjistrimin e fëmijëve (rreth 30 kopje) si dhe ngjitja e posterave për ndihmën juridike



në ambjente publike të komunitetit (rreth 4 kopje).

Kuptohet që materialet eshpërdara u përzgjedhen në bazë të kërkesave të këtij komuniteti. Ky aktivitet zgjati rreth 3 orë.

Numri i përfituesve nga ky aktivitet ishte rreth 80 individë vulnerabël që morën informacion ligjor dhe u sqaruan për paqartësitë që kishin në lidhje me çështjet e tyre ligjore dhe sociale.

Ashtu dhe si ne zonën e “Bregut të Lumit” dhe në këtë zonë është i përqëndruar komuniteti Rom i cili ndeshet me të njëjtat probleme, si probleme me transferimin e dokumenteve të gjendjes civile dhe kalimin e tyre në zyrat e gjendjes civile që kanë juridiksion në këtë zonë, raste për zgjidhje martesë, kërkesa për përfitim të ndihmës ekonomike, probleme rreth çështjeve të pensioneve dhe pajisjen me dokumentet e identitetit.

Edhe pse shumë banorë të këtyre zonave kanë përfituar nga

shërbimet e TLAS, përsëri ky komunitet i ka të nevojshme aktivitetet e “Street Law”, pasi paraqesin probleme permanente deri në ndërhyrjen konkrete të shtetit. Duke regjistruar numrin më të madh të problematikave, tashmë komuniteti Rom është kthyer në vëmendjen kryesore të Shërbimit Ligjor Falas Tiranë.

Rina Pero
Elson Metalla
Studentë të Programit të Inter-
ship të TLAS



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Nr. 3 / 2009

TLAS

